

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësoredhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i kolegjit, Ragip Namani dhe Nebojša Boričić, anëtarë me bashkepunëtor profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **Palës ankuese** :

I. Q., . Prishtinë

Kundër:

A. B.&J. B. , , Prishtinë

Duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA01092), të datës 21 Tetor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 21 Mars 2019, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga **I. Q.** kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, të datës 21 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA01092, refuzohet si e pabazuar
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014, i datës 30 Tetor 2014, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA01092.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 21 Gusht 2007, **I. Q.** (në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP) ku kërkonte ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. ... që ndodhej në vendin e quajtur “...” bnaesa ..., Zona kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar). Sekretaria kishte regjistruar edhe një kërkesë nga pala ankuese me numer KPA01114 që i referohej të gjithë nastres kadastrale ...kurse kërkesa KPA01092 i referohej një pjese të oborrit gjegjësisht 12 metra katrorë të cilat sipas pretendimeve të palës ankuese i kanë marrë nga ngastra e tij palët përgjegjëse në ankesë. Pala ankuese deklaroi se pronën e ka humbur si pasojë e luftës edhe pse në formën e aplikacionit ka shkruar datën e humbjes 1 Janar 1998.

2. Së bashku me kërkesën ai kishte dorëzuar në AKP *inter alia* dokumentet vijuese:

- Kopjën e listës poseduese Nr..., datë 7 Tetor 1993 lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë në Prishtinë ku dëshmohet se ngastra kadastrale ... me sipërfaqe prej 0.03.96 h me kulturë shtëpi dhe oborr evidentohet si pronë shoqerore në emër të Komunës së Prishinës.
- Kopjën e planit datë 7 Tetor 1993 lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë në Prishtinë ku dëshmohet se ngastra kadastrale ... me sipërfaqe prej 0.03.96 h me kulturë shtëpi dhe oborr evidentohet si pronë shoqerore në emër të Komunës së Prishinës.
- Aktvendim i indryshimit të operatit kadastral Nr..., datë 23 Mars 1994 me të cilën lejohej ndërrimi kadastral mbi bazën e kontratës së shitblerjës me numër ..., të datës 24 Shkurt 1994.
- Kontratë e shirblerjës me numër ..., të datës 24 Shkurt 1994 e lidhur në mes të palës ankuese dhe Kuvendit të Komunës së Prishtinës me të cilën pala ankuese blenë banesën në rrugën “...” që përfshinë dy dhoma, një kuzhinë, korridor, kuzhinë verore dhe oborrin si në ngastrën kadastrale ...
- Dokumentat e blerjes së banesës ngjit me pronën e kerkuar Banesa Nr. 2 në emër të V. S.
- Kontrate e shitblerjës e pavertetuar në gjykatë në praninë e dëshmitarëve e lidhur me 5 Qershor 1998 në mes të qiftit J., M. dhe Ž. si shitës dhe palës ankuese si blerës me të cilën nga shitësit pala ankuese blenë 46 metra katrorë të oborrit që evidentohen në ngastrën kadastrale ..., ku sipas nenit 3 të kontratës blerësi merr tokën në shfrytëzim pa të drejtë privatizimi.
- Kopjen e planit e datës 21 Shtator 1967 me të cilin dëshmohet se ngastra kadastrale ..., evidentohet si tokë shoqerore me shfrytëzues qiftin J. me sipërfaqe prej 0.01.53 h.
- Aktvendim mbi dhënjën në shfrytëzim të banesës numër ... në rrugën ... që perbehet nga dy njësi banesore dhe është në pronësi të fondit banesor të Komunës së Prishtinës .
- Aktvendim i Komisionit të Kuvendit të Republikës së Sebisë për aplikimin e ligjit për kushtet e veçanta të shitjes së paluajtshmërive me numer 10 Broj ..., i datës 19 Nëntor 1997 me të cilin aprovohej ankesa dhe lejohej ndërrimi i paluajtshmërive midis palës ankuese dhe V, S.

3. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e kishte vendosur shenjën e njoftimit me 13 Qershor 2008 dhe kishte gjetur se prona ishte oborr prapa shtëpisë dhe se ishte pëgjigjur A. B., i cili kishte pretenduar të drejta mbi pronën

4. Më 5 Maj 2010 Sekretaria Ekzekutive e AKP-së e kishte vizituar pronën prap dhe kishte identifikuar se prona e kerkuar sipas kërkes tjetër pëmban edhe një barakë e cila ishte e

pabanuar dhe se A. B., e ka pohuar se ajo është e palës ankuese dhe ka refuzuar të nënshkruaj pjesmarrjen ne procedurë .

5. Arsim Berisha paraqiti kundërkërkesë me 2 Korrik 2008 duke pohuar se pjesa të cilën e kërkon pala ankuse -12 metra katrorë oborr nuk është e tij por e palës pergjegjëse dhe për këtë paraqiti kopjën e planit të ngastrës ... me sipërfaqe prej 37 metra katrorë ndërtesë dhe 429 metra katrorë oborr e evidentuar si pronë shoqëre e Komunës së Prishtinës, në shfrytëzim të babait të tij Xh. B.
6. Sipas raporteve të Verifikimit të 7 korrik 2011, prona e kërkuar ishte gjetur e regjistruar në Kadaster si pronë shoqerore e Kuvendit të Komunës së Prishtinës për të cilën ishte siguruar edhe certifikata pronësore e datës 24 Qershor 2011. Dokumentat e paraqitura nga pala ankuese nuk ishin gjetur në regjistrat publik dhe verifikimi ishte negativ.
7. Më 21 Tetor 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/260/2014 (në tekstin e mëtejme: “Vendimi i KKPK-së”, “Vendimi”) e kishte hedhur poshtë kërkesën për shkak të faktit se ajo binte jashtë juridiksionit të Komisionit sipas arsytimit që i është dhënë në paragrafin 18 për kërkesën KPA01092 dhe 19 për kërkesën KPA 01114 pasi që posedimi i pronës së kërkuar nuk ishte humbur si rezultat i konfliktit të armatosur që kishte ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Gjithashtu, KKPK-ja konsideroi se nuk kishte juridiksion për sa i përket kërkesave për të cilat posedimi nuk ishte humbur gjatë konfliktit dhe si rezultat i rrethanave që lidhen me konfliktin. Për me tepër KKPK-ja nuk kishte juridiksion për kompensim për shfrytëzimin e pronës pa pëlqim e as autoritet te beje ndryshime kadastrale.
8. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 3 Shkurt 2015. Ai kishte paraqitur ankesë më 3 Mars 2015. Pala përgjegjëse në ankesë 1 ashtu edhe pala përgjegjëse në ankesë 2 kishin marrë Vendimin e KKPK-së më 18 Shkurt 2015.
9. Ankesa i është dorëzuar A. B. me 28 Janar 2016 dhe ai e J. B. janë përgjigjur me 24 Shkurt 2016. J. B. është përgjigjur për kërkesën KPA01114 duke kërkuar që ankesa e përmendur të refuzohet sepse për gjysmën e ngastrës ... ai ka marr leje nga Komuna dhe ka ndertuar objektin banesore në të cilin jeton edhe tani. Për të mbështetur pretendimet e tij ai ka paraqitur keto dokumente:
 - Aktvendim i Drejtoratit Komunal të Urbanizimit, ndertimtarisë së Komunës së Prishtinës 05 Nr.... datë 5 Qershor 2006 me të cilin J. B., si investitor i lejohej ndertimi i banesës mbi themelet e ndërteses se vjeter në ngastren kadastrale ...,
 - Aktvendim për dhenjen e perkohëshme të tokës komunale në shfrytëzim 01 Nr.... datë 7 Maj 2003 me te cilin J. B. i ipej në shfrytëzim gjysma, gjegjësisht ½ nga ngastra kadastrale ...

- Kushtet urbano teknike për ndërtimin në 1/2 të ngastrës kadastrale ... që i caktoheshin J. B., për ndërtim 05 Nr. ... Datë 17 Korrik 2003
- Dokumentacioni i ndarjes dhe ai teknik për objektin e ndërtuar
- Dëshmi të kmunalive, foto të tragjedisë familjare etj por pa relevance për çështjen konkrete.

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese thekson se gabimisht është vënë data e humbjes 01.01.1998 por duhet të jetë 01.06.1998. Më tej pretendon se Vendimi i KKKPK-së është marrë në shkelje të ligjit matrial, rregullave të procedurës dhe se nuk është konstatuar gjendja faktike
11. Ai më tej deklaron se ka paraqitur prova të mjaftueshme se J. B., ka uzurpuar ngastren ..., në sipërfaqe prej 170 metra katrorë ndërsa Arsim berisha ka uzurpuar 12 metra katrorë të ngastres ... Ai pretendon se e ka dëshmuar me kontratën e shitblerjes se e ka blerë ngastrën ... nga Z. S. dhe Ž. J.
12. Përfundimisht i propozon Gjykatës Supreme që ta aprovoi ankesën e tij dhe të anuloi Vendimin e KKKPK-së duke aprovuar kërkesën e tij për kthimin e posedimit mbi pronën e kërkuar.

Pretendimet e palës përgjegjëse

13. Pala përgjegjëse Arsim Berisha deklaron se ajo pjesë e oborrit që pretendon pala ankuese është e tij dhe se pa të drejte ai e pengon në posedim duke gërrmuar afër shtepise se tij dhe kërkon nga autoritetet që ta mbrojnë nga veprimet e tij.
14. Pala përgjegjëse J. B. deklaron se këtë pronë e ka fituar me ndarje nga Komuna e Prishtinës dhe se ankesa e palës tjetër duhet refuzuar për shkak se pala ankuese nuk ka pronësi mbi token e Komunes.

Arsyetimi ligjor

15. Objekt i shqyrtimit i kesaj ankese është kërkesa KPA 01092 që lidhet me një sipërfaqe prej 12 metra katrorë qe ndoshet ne mes te pronave dhe pretendohet nga te dyja palët.
16. Gjykata Supreme, pasi që kishte shqyrtuar pretendimet në ankesë dhe përmbajtjen e dosjës së lëndës, konstaton se Vendimi KKKPK-së nuk përfshinë asnjë gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe as nuk mbështetet në vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Prandaj, ankesa nuk mund të miratohet.

17. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë të zgjidh kërkesat pronësore që kanë të bëjnë me konfliktin dhe kërkesat për të drejtën pronësore “që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 apo që rezultojnë nga ai.” Kjo do të thotë se fushëveprimi i shqyrtimit të AKP-së është të verifikoj elementet vijuese: kush ka qenë në posedim të pronës së kërkuar para datës 27 shkurt 1998, kush është në posedim të saj tani, kur dhe për çfarë arsye është humbur posedimi gjatë periudhës në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Nëse Komisioni e vërteton se posedimi i pronës së kërkuar ishte humbur para apo pas datave që cekën më lartë, apo që humbja e posedimit nuk ka pasur të bëjë me konfliktin, ajo hedhë poshtë kërkesën mbi bazën e nenit 11.4(b) të Ligjit nr. 03/L-079.
18. Sipas verifikimit të Sekretarisë ekzekutive dhe pohimit të palës ankuese në rastin konkret kemi të bëjmë me konflikt vijash kufitare dhe se kjo nuk ka ndodhur si rezultat i konfliktit por kontesti daton para kohës së paraparë në dispozita ligjore.
19. Shqyrtimi i elementeve të tjerë që i referohen çështjes së vlefshmërisë të Kontratës së Shitblerjës apo çështjes së arsyeve se përse palët përgjegjëse nuk e lëshojnë tokën, duke konsideruar se kasnë të drejtë mbi këtë pronë, bien jashtë kompetencës së AKP-së.
20. Siç duket nga dosja e lëndës, pala ankuese në kërkesën KPA01092 kërkon një pjesë të ngastrës kadastrale ... me spefaqe prej 12 metra katrorë dhe se e pohon se humbja e posedimit ka ndodhur në vitin 1998 (sipas deklaramit no formulari e paraqitjes së Kërkesës me 1 Janar 1998 ndërsa në ankesë përmendet data 1 Qershor 1998) me tejkalim nga ana e fqinjit duke hyrë në pronën e palës ankuese dhe uzurpuar pa të drejtë 12 metra katrorë.
21. Gjithashtu, Gjykata Supreme dëshiron të theksoj se pala ankuese kishte pohuar se në asnjërin kërkesë humbja e posedimit nuk lidhet me konfliktin e armatosur. Në rastin konkret ka të bëjë me tejkalim të vijes kufitare sipas pretendimeve të palës ankuese dhe pa i vlersuar fare meritat e ankesës Gjykata gjeti se Vendimi KKPK-së për hudhje të kërkesës për mungesë të juridiksionit ishte i bazuar në Ligjin 03/L-079.
22. Gjykata Supreme, vlerëson se pala ankuese nuk ka dëshmuar se humbja e posedimit të pronave të kërkuara ka të bëjë me konfliktin. Andaj padyshim vërtetohet se KKPK, si në vendimin e saj, me të drejtë dhe bazë ligjore ka marrë vendim të drejtë kur ka gjetur se kërkesa e palës ankuese nuk është përmbajtësore ashtu si parashihet në nenin 3.1, paragraf 3., të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, andaj kërkesa si e tillë është hedhur poshtë, sepse pala ankuese nuk ka arritur ta dëshmojë humbjen e të drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar, menjëherë para, ose gjatë konfliktit të vitit 1998/99. Prandaj ankesa është e pa bazuar dhe e njëjta refuzohet.

23. Poashtu është e pabazuar që Agjencia Kosovare e Pronës nuk ka pasur juridiksion mbi kërkesat për kompensim apo përmiresim të regjistrave kadastral, kërkesa e palës ankuese për këtë çështje është dashur të hedhet poshtë si e papranueshme mbi bazën e nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079 që përmendet lartë *a contrario*.
24. Duke marr parasysh atë që u tha më lartë, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese për të kërkuar të drejtat e tij para gjykatës kompetente, nëse ai e sheh këtë të domosdoshme.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NE PRISHTINE

GSK-KPA-A-003-2016 me datën 21 Mars 2019

Bashkp. Profesional

Sherif Krasniqi

KRYETARI I KOLEGJIT

Beshir Islami